



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Bazuar në nenin 62.3shkronja b) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040, nenin 8 parag. 3.3 të Rregullores MF – Nr-04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenin 64.4 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, Drejtoria e Shëndetësisë dhe mirëqenies Sociale, bën këtë:

NJOFTIM PUBLIK PËR DËRGIMIN E PROPOZIMEVE PËR ANËTAR TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR SUBVENCIONIMIN E OJQ-ve

Njftohen përfaqësuesit e Organizatave të Shoqërisë Civile – OJQ-ve se mund t'i dërgojnë propozimet e tyre për plotësimin e Komisionit vlerësues i cili do të ngritet me qëllim të vlerësimit të aplikacioneve të OJQ-ve, për mbështetje financiare publike të OJQ-ve, të cilët aplikojnë sipas:

- **Thirrjes publike me nr. Prot.06-400/03-0027908/24, date 29.04.2024, për mbështetje financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve**

Për thirrjen e cekur publike do të ngritet një (1) Komision Vlerësues përkatës.

Në kuadër të Komisionit do të përfshihen:

- Një përfaqësues nga OJQ-të,
- Një përfaqësues nga shoqëria Civile në cilësinë e ekspertit

Personat e nominuar për Komisionin Vlerësues, ndër të tjera, duhet t'i dorëzojnë; CV e tyre specifikohen përvojat e mëhershme në fushën e zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të projekteve të ndryshme si dhe një Letër Interesim – rekomandim për pjesëmarrje në këtë Komision, ku prezantohen arsyet e nominimit.

Përzgjedhja e përfaqësuesve bëhet nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Afati për aplikim është nga data **02.05.2024 deri më 17.05.2024**

Propozimet e juaja i dërgoni në postën elektronike zyrtare; dshms.podujeva@rks-gov.net

Nr.prot. 06-020/04-0028891/24
Podujevë, datë: 02.05.2024

